

Drejtuar:
KËSHILLIT MËSIMOR SHKENCOR
TË FAKULTETIT PEDAGOGJIK

Në bazë të nenit 182 të Ligjit të Arsimit të Lartë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.82/2018 dhe 178/2021), Rregullores për kriteret dhe procedurën e zgjedhjes dhe thirrjes mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, Statutit të Universitetit të Tetovës dhe nevojës për angazhimin e personave në thirrje të titulluara, me Vendim të Këshillit Mësimor - Shkencor të Fakultetit Pedagogjik të Universitetit të Tetovës me numër 24-1302/1 të datës: 01.12.2023, në bazë të Konkursit të shpallur më 17.11.2023 në gazetata ditore “Koha” dhe “Sloboden Peçat” dhe në ueb faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës <https://unite.edu.mk/>, për zgjedhjen e një mësimdhënësi në thirrje të titulluar Docent/Profesor Inordinar në lëmin e Metodikës, Të tjera (50504,50525 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë – hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), mori Vendim për formimin e Komisionit recensues me numër 24-1302/1, në përbërje:

- Prof. dr. Dançe Sivakova, (kryetare)
- Prof. dr. Besa Havziu - Ismaili, (anëtare)
- Prof. dr. Jasminka Koçoska, (anëtare)

Duke ju falënderuar për besimin e dhënë, Komisioni recensues ka nderin të paraqesë këtë:

REFERAT

Për zgjedhje/rizgjedhje të një mësimdhënësi në thirrje të titulluar Docent në fushën e Metodikës,Të tjera (50504,50525 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë – hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)

Të dhënat biografike dhe arsimimi:

Kandidatja, Dr.sc. Merita Ajdini, ulind më datë 24.01.1973 në Shkup.Shkollimin fillor e kreu në Shkollën Filllore “Petar Zdravkovski Penko” në Shkup, ndërsa shkollimin e mesëm nëGjimnazin “ Zef Lush Marku” po ashtu në Shkup.

Në vitin 1991 regjistrohet në Akademinë Pedagogjike “Shën Klimenti i Ohrit” Shkup.Më datë 23.11.1993 merr titullin **Arsimtar i Diplomuar i Mësimit Klasor**. Zhvillimi profesional i saj vazhdon edhe më tutje duke u regjistruar në vitin 1997 në Fakultetin Pedagogjik“Shën Klimenti i Ohrit” - Shkup. Më datë 22.06.1998 merr titullin **Profesor i Diplomuar i Mësimit Klasor** dhe është numëruar në mesin e dhjetë studentëve të parë të diplomuar në këtë fakultet.

Edhe pse ka mbaruar Fakultetin Pedagogjik, drejtimi mësimi klasor, zhvillimi i saj profesional vazhdon edhe më tutje duke u regjistruar në vitin 2019 në Universitetin e Tetovës,Fakulteti Pedagogjik, drejtimi - pedagogji profesionale. Më datë 06.12.2021 mbron temën e diplomës me titull: “Zhvillimi profesional dhe ai në karrierë i arsimtarëve në shkollat fillore” dhe merr titullin **Pedagog i Diplomuar**.

Studimet e magjistraturës i vazhdoi nëUniversitetin “Shën Cirili dhe Metodi” në Fakultetin Pedagogjik “Shën Klimenti i Ohrit” në Shkup,ku me sukses të dalluar kreu studimet me mesataren**10** dhe e mbrojti temën e magjistraturës me titull: “Lojërat dhe roli i tyre në të mësuarit e matematikës prej klasës I-III në shkollat fillore”dhe mori titullin: **Magjistër i Mësimit Klasor**.

Zhvillimi i saj profesional dhe interesimi i vazhdueshëm shkencor në fushën e pedagogjisë, didaktikës dhe metodikës vazhdoi me regjistrimin e studimeve të doktoratës në vitin akademik 2019/2020 në Fakultetin Pedagogjik “Shën Klimenti i Ohrit” në Manastir, të cilat i përfundoi me sukses, duke qenë e vlerësuar lart për angazhimin e saj gjatë studimeve të doktoratës. Më datë03.07.2023mbrojti disertacionin e doktoratësme titull: “Lojërat dhe roli i tyre në të mësuarit e matematikës në mësimin klasor”(në origjinal: „Игрите и нивната улога во

учењето математика во одделенската настава”) dhe mori titullin **Doktor i Shkencave Arsimore.**

Veprimtaria edukativo-mësimore:

Në shtator të vitit 1995 u punësua si arsimtare e mësimi klasor në Shkollën Fillore “Koço Racin”, Petrovec, Shkup, ndërsa në shtator të vitit 1998 u transferua në Shkollën Fillore “Mareshali Tito” në Haraçinë, Shkup. Në vitin 2001 si profesor i mësimi klasor u transferua në Shkollën Fillore Komunale “26 Korriku”, Shkup ku edhe sot kryen me përgjegjësi dhe përkushtim të madh detyrën e saj në këtë profesion.

Si rezultat i punës së saj 28-vjeçare si mësimdhënëse e dalluar dhe kontributit të saj të madh në sferën e arsimit, Ministria e Arsimit (pikë maksimale për zhvillimin profesional-80 pikë) në bashkëpunim me Byronë e Zhvillimit të Arsimit (pikë maksimale nga notimi i BZHA – 80 pikë) dhe Shkollës ku punon (pikë maksimale-20 pikë), me 180 maksimum pikë të parapara, më datë 30.06.2021, eavancon në **titullin Arsimtar-Mentor**, duke u bërë një nga mentorët e parë të zgjedhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Veprimtaria e saj vazhdon edhe si bashkëpunëtoare e jashtme në Byronë e Zhvillimit të Arsimit ku dallohet si trajnuese në nivel shtetëror, lokal nëpër shkolla në tërë territorin e vendit tonë,ku grup i synuar kanë qenë: arsimtarët e ciklit të ulët, arsimtarët lëndorë, bashkëpunëtorët profesionalë, drejtorët e shkollave fillore. Është e certifikuar mbi 40 herë nga organizata të shumta të shteteve të jashtme: USAID, OSBE, Nansen Dialog Center, Ministria e Arsimit, Byroja e Zhvillimit të Arsimit, Qendra Shtetërore e Provimeve.

Gjatë viteve të fundit është edhe bashkëpunëtoare në Qendrën Shtetërore të Provimeve ku është e angazhuar në projekte në nivel shtetëror si “Projekti për përparimin e Arsimit Fillor”. Poashtu gjatë këtyre viteve ka një bashkëpunim të ngushtë edhe me Ministrinë e Arsimit ku dallohet me punën e saj në përpilimin e ligjit për arsim fillor.

Në vitin akademik 2023/2024 angazhohet si staf akademik në Fakultetin Pedagogjik në Universitetin e Tetovës – Tetovë. Mbulon ligjëratat dhe ushtrimet në lëndët mësimore: Didaktika e punës edukativo-arsimore e Matematikës II me praktikë pedagogjike në Programin studimor: Drejtimi parashkollor, si dhe ushtrimet nga Didaktika I në Programin studimor: Mësim klasor, cikli i parë i studimeve.

Kandidatja njihet në nivel profesional gjuhën maqedonase, për gjuhën Angleze posedon vërtetim të njohurive në tetë shkallë, apo sipas Kornizës së Përbashkët Referuese të Evropës në nivelin B2, si dhe gjuhët serbe/kroate/boshnjake në nivel mesatar.

Në bazë të Rregullores për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në tituj mësues-shkencorë, shkencorë, mësues profesionalë dhe bashkëpunëtorë të Universitetit të Tetovës, kandidati Dr.sc. Merita Ajdini ka realizuar gjithsej **109.712**pikë në fushën e veprimtarisë edukative-mësuese.

Veprimtaria kërkimore-shkencore

Paralelisht me angazhimet e punës, me kohë të plotë dhe të pjesshme, kandidatja është përfshirë dhe zhvillon edhe kërkime shkencore në fushën e Pedagogjisë. Veprimtaria shkencore-hulumtuese përbëhet prej disa punimeve shkencore të publikuara në revista shkencore ndërkombëtare, pjesëmarrje në konferenca me karakter ndërkombëtar. Këto aktivitete janë të paraqitura si vijojnë:

A) Punime shkencore

1. Merita Ajdini, Bujar Saiti “The importance of the games as activities that the teachers use to improve mathematics learning in grades I-III in primary school. September - Trakya University Faculty of Education- **Edirne, 2018, International Journal of Educational Research**
2. Merita Ajdini, Bujar Saiti -The attitudes and the opinions of the elementary school teachers in grades I-III in several primary schools in Skopje and the surrounding areas about the game activities as motivators during mathematics instruction Trakya University - **Stara Zagora, 2017. p. 53-57.**
3. Merita Ajdini, Bujar Saiti -Views and opinions of class teachers from I-III grade of several elementary schools in Skopje about the use of games of mathematics classes – **Bitola, 2017** p.688-693.
4. Ajdini, Merita - The applicability of multilateral strategies in the function of motivation and perception of textual tasks from the mathematical subject. **Journal of Educational Research, Tetovë, 2019, 1 (1-2). pp. 63-67. ISSN 2671 – 3276. UDC: 159.953.5:51]303.62**
5. Merita Ajdini . Marzanna Seweryn-Kuzmanovska (**2021**) The game and teacher in teaching mathematics in the first cycle of primary school. **Horizont International Scientific Journal** pp.15-22 DOI 10.20544/HORIZONS.B.08.1.21. P02 UDC 373.091.33-028.23:51.

6. Ajdini Merita. MATH'S GAMES AS A MECHANISM FOR SUCCESSFUL LEARNING IN ELEMENTARY CLASSES. **International Scientific Conference "75th Anniversary of the Institute of Pedagogy – Educational Challenges and Future Prospects"**, Ohrid, 16-18 May 2022 © 2022 Institute of Pedagogy, Faculty of Philosophy, Ss. Cyril and Methodius University in Skopje pp.36-41.
7. Merita Ajdini – Matematika përmes lojës në funksion të socializimit të fëmijëve dhe produktivitetit në matematikë, **Revista Pedagogjike – Revista shkencore e çështjeve arsimore**, Viti 8 nr.2 / 2017. 316. 614 : 37. 091. 33 – 027. 22.

B) Pjesëmarrja në konferenca

1. Merita Ajdini, "Games and their role in learning mathematics in the first cycle of primary education" 11 International Balkan Education and Science Congress.12-14.10.2016. **Poreç, Croatia.**
2. Merita Ajdini, Bujar Saiti -The attitudes and the opinions of the elementary school teachers in grades I-III in several primary schools in Skopje and the surrounding areas about the game activities as motivators during mathematics instruction. 12-International Balkan Education and science congress.Trakya University - **Stara Zagora, 2017.**
3. Merita Ajdini, Bujar Saiti -Views and opinions of class teachers from I-III grade of several elementary schools in Skopje about the use of games of mathematics classes – **Bitola, 2017**
4. Ajdini, Merita - The applicability of multilateral strategies in the function of motivation and perception of textual tasks from the mathematical subject. **Tetovo, 2019,**
5. Ajdini Merita. Math'sgames as a mechanism for successful learning in elementary classes. **International Scientific Conference "75th Anniversary of the Institute of Pedagogy – Educational Challenges and Future Prospects"**, **Ohrid, 16-18 May 2022** © 2022 Institute of Pedagogy, Faculty of Philosophy, Ss. Cyril and Methodius University in Skopje

6. Ajdini Merita, Lulzim Mehmedi,. Digital games in learning mathematics-**16-18 November, 2022. Tetovo.**

7. Merita Ajdini, Creating game for solving mathematical textual tasks.VII Congress of mathematicians of Macedonia. **27-30, 2023 Struga.**

Ajo gjithashtu dallohet edhe si pjesëmarrëse në projekte shkencore shtetërore si pjesëmarrëse në shumë grupe punuese me rëndësi për përparimin e arsimit fillor dhe arsimit në tërësi.Komisioni për dhënien e mendimeve për përmirësimin dhe plotësimin e tekstit të librit të matematikës për klasën I, II, III dhe IV. Pjesëmarrëse në grupin punues për përpilimin e Kornizës së vlerësimit me notë për testimin shtetëror të lëndës së matematikës për klasën V. Pjesëmarrëse në grupin punues për përpilimin e detyrave të testimit shtetëror për lëndën e matematikës së klasës V. Pjesëmarrëse në grupin punues për Identifikimin e niveleve të arritjeve të realizuara të klasave të treta në testimin shtetëror të Bankës Botërore në kuadër të"Projektit për përparimin e Arsimit Fillor"

Poashtu dallohet edhe si redaktore në revistën matematikore: Numerus dhe si redaktore përgjegjëse në revistën për fëmijë "Yllka".

Në bazë të Rregullores për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në tituj mësimorë – shkencorë, mësimorë profesionalë dhe bashkëpunëtorë të Universitetit të Tetovës, kandidatja Dr.sc. Merita Ajdini ka realizuar gjithsej **105** pikë në fushën e veprimtarisë kërkimore shkencore.

Veprimtaria profesionale-zbatuese dhe veprimtaria me interes më të gjerë

Si mentor i shkollës është mentoree mbi 140 arsimtarëve të shkollës së saj. Po ashtu për çdo vit mentoron nga dy arsimtarë-praktikantë deri në dhënien e provimit të shtetit. Në bashkëpunim me shërbimin profesional, përpilon Programet Vjetore të Shkollës si dhe Planin Zhvillimor të Shkollës. Kryetare në komisione të shumta shkollore: Komisioni për zhvillim profesional i arsimtarëve, Komisione për përpilimin e planeve për nxënës me nevoja të veçanta

etj. Anëtare e Këshillit të Shkollës. Koordinatore e shumë projekteve në nivel shkollor e lokal në bashkëpunim me USAID-in, OSBE-në, Ministrinë e Arsimit, Byronë e Zhvillimit të Arsimit etj.

Në punën e saj dallohet si eksperte në praktikat e saj shkollore me punën me arsimtarët. Poashtu është edhe autore e librit: **“Lojërat dhe matematika në Ciklin e Parë të Arsimit Fillor”**. Poashtu bën pjesë edhe në përkthimin e një pjese të librit **“Didaktika për prindërit”**, autor Dean Iliev, ka mirënjohje dhe lëvdata edhe nga biblioteka e Universitetit të Tetovës për dhurimin e librave. Mirënjohje nga revistat për fëmijë si dhe falënderim nga Ministri i Arsimit për mësimin e realizuar në TV KLASA në kohën e pandemisë.

Gjatë studimeve të Ciklit të Tretë, Merita Ajdini, në periudhën prej 15.03.2021 deri 23.03.2021 ka realizuar qëndrim studimor në Fakultetin e Edukimit pranë Universitetit “Kadri Zeka”- në Gjilan - Kosovë, në qëndrim njëjavor. Kandidatja ka realizuar ligjërata me studentët e vitit të parë dhe të dytë të dy programeve studimore, Arsimi parashkollor dhe Arsimi fillor në lëndët: Konceptet themelore matematikore, Lojërat matematikore, Metodologjia e mësimin të matematikës për fëmijë, Puna me fëmijë të talentuar dhe mësimdhënia e njohurive gjeometrike, ku ajo ka treguar aktivitet, përgjegjësi të lartë në punë dhe bashkëpunim të frytshëm.

Ka marrë pjesë në Konferenca vendore dhe ndërkombëtare, si dhe në publikimin e punimeve shkencore, angazhime në fushën profesionale, në grupe punuese me interes shtetëror dhe mund të themi se kandidatja tregon interesim të veçantë në fushën ku konkurrenca dhe aftësi kualitative në realizimin e veprimtarisë arsimore-mësimore. Për këtë dëshmojnë edhe **242.712** pikët e grumbulluara nga veprimtaria edukative mësimore, veprimtaria kërkimore-shkencore, veprimtaria profesionale-zbatuese, dhe veprimtaria me interes më të gjerë.

PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMET

Bazuar nga dokumentacioni i përgjithshëm dhe njohja personale me kandidaten, Komisioni recensues e vlerëson pozitivisht veprimtarinë edukative - mësimore, veprimtarinë kërkimore - shkencore, veprimtarinë profesionale - zbatuese si dhe veprimtarinë me interes të gjerë të Dr.sc. Merita Ajdini.

Komisioni vlerëson se Dr. Merita Ajdini posedon cilësi akademike dhe profesionale dhe në bazë të nenit 166 dhe 173 të Ligjit të Arsimit të Lartë (Fleta Zyrtare e RMV-së nr. 82/18) dhe Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës dhe në bazë të dispozitave të Statutit të Universitetit të Tetovës, i plotëson të gjitha kushtet që të zgjidhet në thirrjen DOCENT NË TITULL në fushën shkencore të Shkencave Shoqërore (5), Arsim (505) lëmin shkencor Metodikë (50504) dhe Të tjera (50525) nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë – hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

Nga kjo që u tha më lartë Komisioni ka nderin dhe kënaqësinë që t'i propozojë Këshillit mësimor – shkencor të Fakultetit Pedagogjik të Universitetit të Tetovës, që Dr.sc. Merita Ajdini të zgjidhet në thirrjen e titulluar DOCENT në lëmin shkencor të Metodikës dhe Të tjera.

Komisioni recensues:

- Prof. dr. Dançe Sivakova, (kryetar)

- Prof. dr. Besa Havziu - Ismaili, (anëtar)

- Prof. dr. Jasminka Koçoska, (anëtar)

Data: 06.12.2023, Tetovë.

SHTOJCA

PËR RAPORTIN E ZGJEDHJES NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË DHE MËSIMORË-PROFESIONALË

Kandidati: Merita Ajdini

Institucioni: Fakulteti Pedagogjik – UT, Tetovë

Lëmi shkencor: Arsimi

Fusha shkencore: Metodika, Të tjera

VEPRIMTARIA EDUKATIVE-MËSIMORE

Nr. rend	Emri i aktivitetit:	Pikë
1	Mbajtja e ligjëratave dhe ushtrimeve (lëndët në Ciklin e Parë të Studimeve) 2023/2024 (Semestri dimëror)	3.6
1.1.	Ligjërata: Didaktika e punës edukativo-arsimore e matematikës II me Praktikë Pedagogjike Ushtrime: Didaktika e punës edukativo-arsimore e matematikës II me Praktikë Pedagogjike	2x15x1x0.04= 1.2 2x15x1x0.04= 1.2
1.2.	Ushtrime: Didaktikë I	2x15x1x0.04= 1.2
2	Konsultime me studentë	0.112
2.1.	Didaktika e punës edukativo-arsimore e matematikës II me Praktikë Pedagogjike ➤ Programi studimor: ➤ Drejtimi parashkollor, 16 studentë	16x0.002= 0.032
2.2.	Didaktikë I ➤ Programi studimor: ➤ Mësim klasor, 40 studentë.	40x0.002= 0.08
3	Mësimi në shkolla dhe punëtori	53
3.1.	Trajnues dhe kreator i materialeve për mësim në Qendrën profesionale për trajnim, Arsimi profesional dhe Arsimi për të rritur CES – Shkup, ku realizon trajnime profesionale të arsimtarëve.	1
3.2.	Udhëheqëse e seminarit (Trajnuese)	15
	Realizim i trajnimit në temën: Strategjia e menaxhimit në klasë – Parime dhe shembuj të praktikës së mirë për krijimin e atmosferës pozitive të punës në klasë dhe online/ klasa virtuale. CES. CERTIFIKATË PËR TRAJNUES, 2023	1.5
	Realizim i trajnimit në temën: Bashkëpunimi profesional i	1.5

	arsimtarëve (aktive profesionale, komunitete të mësimnxënies, mentorim etj.) CES. CERTIFIKATË PËR TRAJNUES,2023.	
	Realizim i trajnimit në temën: Arsimi mediatik. USAID, IREX, Instituti i Mediemeve i Maqedonisë. CERTIFIKATË PËR TRAJNUES, 2022.	1.5
	Realizim i trajnimit në temë: Hulumtimet aksionare në procesin edukativo-arsimor. Byroja e Zhvillimit të Arsimit. CERTIFIKATË PËR TRAJNUES, 2015.	1.5
	Realizim i trajnimit në temën: Mendo matematikisht (trajnimi i mësimdhënësve të klasave I-V për realizimin e orëve, vëzhgim i orëve të realizuara nga mësimdhënësit). Byroja e Zhvillimit të Arsimit. CERTIFIKATË.	1.5
	Arsim për shkathtësi jetësore (trajnimi i mësimdhënësve të klasave I-V për realizimin e punëtorive, vëzhgim i punëtorive të realizuara nga mësimdhënësit).	1.5
	Realizimi i trajnimit: Arsimi multikulturor. Realizim i punëtorive multikulturore gjatë viteve shkollore: 2015/2016 dhe 2016/2017. CERTIFIKATË.	1.5
	Realizim i trajnimit me temë: Puna me TIK, Laptopët Intel, Programet Tool Kid, G-Compris. Byroja e Zhvillimit të Arsimit. CERTIFIKATË.	1.5
	Realizim i trajnimit “Të mësuarit nëpërmjet përvojës dhe integrimi në konceptet e shkencave natyrore, mjedisit jetësor dhe ndryshimet klimatike në sistemin arsimor” UNICEF, Shteti Suedez, CERTIFIKATË.	1.5
	Realizim i trajnimit me temë: Stop dhunës gjinore dhe familjare – ANTICO, Nisma qytetare e grave.	1.5
3.3.	Pjesëmarrëse në punëtori	37
	Projekt për modernizimin e arsimit: Metodatat dhe teknikat bashkëkohore dhe kreative në mësimnxënie dhe modernizimi i arsimit. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Qendra Algoritmi.	1
	Arsimimi mediatik: “Të rinjtë mendojnë”, USAID,IREX, Instituti i mediemeve të Maqedonisë. CERTIFIKATË	1
	Hulumtimi aksional në praktikën edukativo-arsimore. Byroja e Zhvillimit të Arsimit. CERTIFIKATË	1
	Projekti i USAID-it: Aplikimi i suksesshëm në qasje bashkëkohore në mësimin e matematikës dhe Njohja me rrethinën në grupin klasor. USAID, Byroja e Zhvillimit të Arsimit. CERTIFIKATË.	1
	Projekti i USAID-it: Realizimi i suksesshëm i aktiviteteve për integrim ndëretnik në arsim. USAID. PINA. BZHA. CERTIFIKATË	1
	Bazat e Demokracisë. Byroja e Zhvillimit të Arsimit. CERTIFIKATË.	1

	Basic IT Training for Windows, MS Word, MS Excel, MS Power Point. USAID. CERTIFIKATË.	1
	Projekt për modernizimin e arsimit: Gjuha angleze –kursi fillestar 40 orë. MASH. CERTIFIKATË.	1
	Projekt për modernizimin e arsimit: Gjuha angleze –kursi i avancuar 40 orë. MASH. CERTIFIKATË.	1
	Projekt për modernizimin e arsimit: Teknologji informatike: Microsoft Access. MASH. Qendra Algoritmi, 32 orë. CERTIFIKATË.	1
	Projekt për modernizimin e arsimit: Teknologji informatike: Microsoft Windows, Microsoft Word, Microsoft Excel, 32 orë. MASH. Qendra Algoritmi, CERTIFIKATË.	1
	Projekt për modernizimin e arsimit: Teknologji informatike: Microsoft Excel i avancuar, 32 orë. MASH. Qendra Algoritmi, CERTIFIKATË.	1
	ToolKID Educational Software. USAID. EDC.MASH. CERTIFIKATË.	1
	Macedonia Intel Learning Series. Thecnology Adoption Initiative. INTEL. CERTIFIKATË.	1
	Projekti: Mundësi të barabarta për arsim të fëmijëve romë. Tema: Arsimi për drejtësi sociale për të rritur. Ambasada Holandeze, Fondacioni “Hap pas hapi” dhe “Shoqëria e Hapur”. CERTIFIKATË.	1
	Tema: Parandalimi dhe lufta kundër trafikimit të fëmijëve. Council of Europe.MASH.BZHA. CERTIFIKATË.	1
	Shkrim-leximi fillestar – BZHA CERTIFIKATË	1
	Mendo matematikisht – BZHA CERTIFIKATË	1
	Kontribut për realizimin e mësimin në distancë, TV Klasa. MASH, BZHA, UNICEF. CERTIFIKATË	1
	Tema: integrimi mes përmbajtjeve, kompetenca dygjuhësore planifikimi i aktiviteteve të integruara jashtë mësimore. Nivel bazik. Qendra për Dialog Nansen, Shkup Këshilli për arsim të integruar të Irlandës. 40 orë. CERTIFIKATË.	1
	Tema: principet, qëllimet dhe detyrat e arsimit të integruar, kurikula nacionale. Niveli bazik. Qendra për Dialog Nansen, Shkup Këshilli për arsim të integruar të Irlandës. 40 orë. CERTIFIKATË.	1
	Trajnim bazë për integrim ndëretnik në arsim. USAID. MCGO.BZHA.PINA. CERTIFIKATË.	1
	Projekti: Building Bridges Fund. Misioni i OSCE. CERTIFIKATË.	1
	English language -5 level Tower Bridge. CERTIFIKATË.	1
	Trajnim/Vebinar Formimi i shtigjeve të personalizuar mësimore për nxënësit. CERTIFIKATË	1

	Trajnim/Pjesëmarrje aktive në Përgatitjen për testimin PIRLS.	1
	Projekt i USAID-it “Leximi ju bën udhëheqës“, trajnim për përdorimin e instrumenteve për vlerësim të shkrim-leximit gjuhësor dhe matematikor (EGRA dhe EGMA), (2016)	1
	Trajnim: Wir bitten zum Tanz. Friedensbrugg-Bridge of peace. CERTIFIKATË.	1
	Trajnim në distancë-Programi Fëmijët dhe Familjet në Arsim. Universiteti për arsimin e mësimdhënësve nga Cyrihu. Zvicër. Vërtetim.	1
	Aplikim praktik-Programi Fëmijët dhe Familjet në Arsim. Universiteti për arsimin e mësimdhënësve nga Cyrihu. Zvicër. Vërtetim.	1
	Aplikim praktik i Programit: Mendojmë matematikisht. CERTIFIKATË.	1
	Hyrje në Excel – Microsoft 365. Microsoft, Real Visualz. Parma. Italy.	1
	Trajnim në distancë: Mësoj të bëhem ndërmarrës. Qendra e Edukimit. STEM. Vërtetim.	1
	Trajnim në distancë: Klasa e përmbysur- koncepte, strategji dhe resurse të nevojshme për zbatim.	1
	Trajnime në distancë: Klima shkollore dhe plan programi mësimor-Ndërtimi i klimës, kulturës shkollore, sesioni për zhvillim dhe futjen e lëndëve zgjedhore dhe aktiviteteve jashtëshkollore. CERTIFIKATË.	1
	Trajnime në distancë: Përfshirja e fëmijëve refugjatë, emigrantë, pa shtetësi, azilkërkues, në procesin edukativo-arsimor.	1
	Trajnim për arsimtar për implementimin e mësimin në vend të hapur në kuadër të projektit GLOW.	1
	Gjithsej	109.712

VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE

Nr. rendor	Emri i aktivitetit:	Pikë
1	Teza të mbrojtura	12
1.1.	“Lojërat dhe roli i tyre në të mësuarit e matematikës prej klasës I-III në shkollat fillore” Mbrojtje e temës së magjistraturës, Fakulteti Pedagogjik: “Shën. Klimenti i Ohrit”, Shkup, 30.11.2015.	4
1.2	“Lojërat dhe roli i tyre në të mësuarit e matematikës në grupin klasor “ <i>(në origjinal: „Игрите и нивната улога во учењето математика во одделенската настава”)</i> . Mbrojtje e disertacionit të doktoratës. Fakulteti Pedagogjik: “Shën. Klimenti i Ohrit”, Manastir, 03.07.2023.	8
2	Punime me rezultate shkencore origjinale me impakt faktor, të publikuara në revista shkencore me bord ndërkombëtar, të indeksuara në së paku një bazë elektronike të revistave me punime të qasshme në internet, siç janë: Ebsco, Emerald, Scopus, ...	5
2.1.	1. Merita Ajdini , Bujar Saiti “The importance of the games as activities that the teachers use to improve mathematics learning in grades I-III in primary school. September - Trakya University Faculty of Education - Edirne, Turkey, 2018, p.333-337, ISBN978-975-374-228-3	5
3	Punime shkencore me rezultate origjinale të publikuara në revista shkencore me këshill redaktues ndërkombëtar	15
3.1.	1. Merita Ajdini , Bujar Saiti -The attitudes and the opinions of the elementary school teachers in grades I-III in several primary schools in Skopje and the surrounding areas about the game activities as motivators during mathematics instruction Trakya University - Stara Zagora, 2017. p. 53-57.	3
3.2.	2. Merita Ajdini , Bujar Saiti -Views and opinions of class teachers from I-III grade of several elementary schools in Skopje about the use of games of mathematics classes – Bitola, 2017 p.688-693.	3
3.3	3. Ajdini, Merita - The applicability of multilateral strategies in the function of motivation and perception of textual tasks from the mathematical subject. Journal of Educational Research, Tetovë, 2019, 1 (1-2). pp. 63-67. ISSN 2671 – 3276. UDC: 159.953.5:51]303.62	3
3.4	4. Merita Ajdini . Marzanna Seweryn-Kuzmanovska (2021) The game and teacher in teaching mathematics in the first cycle of primary school. Horizont International Scientific Journal pp.15-22 DOI 10.20544/HORIZONS.B.08.1.21. P02 UDC 373.091.33-028.23:51.	3

3.5	5. Ajdini Merita . MATH'S GAMES AS A MECHANISM FOR SUCCESSFUL LEARNING IN ELEMENTARY CLASSES. International Scientific Conference "75th Anniversary of the Institute of Pedagogy – Educational Challenges and Future Prospects", Ohrid, 16-18 May 2022 © 2022 Institute of Pedagogy, Faculty of Philosophy, Ss. Cyril and Methodius University in Skopje pp.36-41.	3
4	Pjesëmarrje në konferenca hulumtuese-shkencore	14
4.1.	1. Merita Ajdini , "Games and their role in learning mathematics in the first cycle of primary education" 11 International Balkan Education and Science Congress.12-14.10.2016. Poreç, Croatia.	2
4.2.	2. Merita Ajdini , Bujar Saiti -The attitudes and the opinions of the elementary school teachers in grades I-III in several primary schools in Skopje and the surrounding areas about the game activities as motivators during mathematics instruction. 12-International Balkan Education and science congress.Trakya University - Stara Zagora, 2017.	2
4.3.	3. Merita Ajdini , Bujar Saiti -Views and opinions of class teachers from I-III grade of several elementary schools in Skopje about the use of games of mathematics classes – Bitola, 2017	2
4.4	4. Ajdini, Merita - The applicability of multilateral strategies in the function of motivation and perception of textual tasks from the mathematical subject. Tetovo, 2019,	2
4.5	5. Ajdini Merita . Math's games as a mechanism for successful learning in elementary classes. International Scientific Conference "75th Anniversary of the Institute of Pedagogy – Educational Challenges and Future Prospects", Ohrid, 16-18 May 2022 © 2022 Institute of Pedagogy, Faculty of Philosophy, Ss. Cyril and Methodius University in Skopje	2
4.6	6. Ajdini Merita , Lulzim Mehmedi,. Digital games in learning mathematics-16-18 November, 2022. Tetovo.	2
4.7	7. Merita Ajdini , Creating game for solving mathematical textual tasks.VII Congress of mathematicians of Macedonia. 27-30, 2023 Struga.	2

5	Abstrakt i publikuar në përmbledhje të punimeve të konferencës	3
5.1.	1. Merita Ajdini , Creating game for solving mathematical textual tasks.VII Congress of mathematicians of Macedonia. 2023.	1
5.2	2. Merita Ajdini , Besa Havziu Ismaili, Lulzim Mehmedi “Games and its role in learning mathematics in primary education classes” ICIPE’ 2023. Tirana.	1
5.3	3. Lulzim Mehmedi, Merita Ajdini , Besa Havziu Ismaili. Strategies of high influence and their effect on improvement of teaching and knowledge acquisition at students. 2023 Tetovë.	1
6	Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në Revista shkencore/profesionale	8
6.1.	1. Merita Ajdini – Matematika përmes lojës në funksion të socializimit të fëmijëve dhe produktivitetit në matematikë, Revista Pedagogjike – Revista shkencore e çështjeve arsimore, Viti 8 nr.2 / 2017. 316. 614 : 37. 091. 33 – 027. 22.	4
6.2	2. Revista matematikore NUMERUS, ISSN 1409-875X, Redaktore.	4
7	Pjesëmarrëse në projekte shkencore shtetërore	48
7.1	Pjesëmarrëse në grupin punues për përpilimin e kornizës për notim për testimin shtetëror për lëndën matematikë për klasën V. Nga banka botërore në kuadër të "Projektit për përparimin e arsimit fillor"	6
7.2	Pjesëmarrëse në grupin punues për përpilimin e detyrave në testimin shtetëror për lëndën matematik për klasën V. Nga banka botërore në kuadër të "Projektit për përparimin e arsimit fillor"	6
7.3	Pjesëmarrëse në grupin punues për identifikimin e niveleve të arritjeve të realizuara te klasat e treta për testimin shtetëror. Nga banka botërore në kuadër të "Projektit për përparimin e arsimit fillor"	6
7.4	Pjesëmarrëse në grupin punues në nivel shtetëror për analizë të përmbajtjeve të planeve mësimore, programeve dhe librave, në aspekt të përparimit të mundësive të barabarta të meshkujve dhe femrave.	6
7.5	Pjesëmarrëse në komision në nivel shtetëror për dhënie të mendimeve për përmirësimin dhe plotësimin e tekstit të librit të matematikës për klasën I.	6
7.6	Pjesëmarrëse në komision në nivel shtetëror për dhënie të mendimeve për përmirësimin dhe plotësimin e tekstit të librit të matematikës për klasën e II.	6
7.7	Pjesëmarrëse në komision në nivel shtetëror për dhënie të mendimeve për përmirësimin dhe plotësimin e tekstit të librit të matematikës për	6

	klasën e III.	
7.8	Pjesëmarrëse në komision në nivel shtetëror për dhënie të mendimeve për përmirësimin dhe plotësimin e tekstit të librit të matematikës për klasën e IV.	6
Gjithsej		105

VEPRIMTARIA PROFESIONALE – APLIKATIVE

Nr. rendor	Emri i aktivitetit:	Pikë
1	Koordinatore për përgatitjen e elaboratit për program të ri studimor	4
1.1.	Bashkëpunim me Shërbimin profesional të shkollës për përpilimin e Planit zhvillimor të shkollës.	1
1.2.	Bashkëpunim me Shërbimin profesional të shkollës për përpilimin e Programit vjetor të shkollës.	1
1.3.	Koordinatore e aktivitetit profesional të grupit klasor.	1
	Koordinatore e shkollës për projektin: Multikulturalizmi. Kryetare e komisionit për zhvillim profesional të arsimtarëve.	1
2	Aktivitete si ekspert	5
2.1.	Vetevaluim i punës së shkollës, hulumtime dhe përfundime nga analiza e bërë.	1
2.2	Mentorim dhe përcjellje e punës së arsimtarëve në shkollë, në cilësinë e mentorit të shkollës.	1
2.3	Mentorim rreth realizimit të hulumtimeve aksionale të arsimtarëve si dhe arsimtarëve – praktikantë për provim të shtetit.	1
2.4	Mentorim i arsimtarëve – praktikantë në orët mësimore dhe përgatitja për dhënien e provimit.	1
2.5	Ligjëratë interne: Zhvillimi profesional i arsimtarëve- Plani individual i zhvillimit profesional.	1
3	Përkthim nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe	1
3.1.	Përkthim i një pjese të librit <i>Didaktika për prindërit</i> , autor Dean Iliev, Koçani: Europe 92, 2021	1
4	Përgatitje e lëndës së re	1
4.1.	Përgatitje për lëndën e re Didaktika e punës edukativo-arsimore e matematikës II me Praktikë Pedagogjike	1
5	Libra nga fusha profesionale - autor	8
5.1.	Merita Ismaili Ajdini, Lojërat dhe matematika në ciklin e pare të arsimit fillor. Shkup, 2020. ISBN 978-608-245-520-4.	8
6	Mirënjohje	8
6.1	Mirënjohje nga Biblioteka e universitetit të Tetovës, për dhurimin e librit: Lojërat dhe matematika në ciklin e pare të arsimit fillor.	4
6.2	Mirënjohje nga revista për fëmijë “Yllka”, Shkup.	4

	Gjithsej	27
--	-----------------	-----------

VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJERË

Nr. rendor	Emri i aktivitetit:	Pikë
1	Qëndrim studimor në botën e jashtme	0,5
1.1.	Qëndrim studimor prej 15.03.2021 deri 23.03.2021 në Fakultetin e Edukimit pranë Universitetit “Kadri Zeka”- në Gjilan - Kosovë, në qëndrim njëjavor. Kandidatja ka realizuar ligjërata me studentët e vitit të parë dhe të dytë të dy programeve studimore, Arsimi parashkollor dhe Arsimi fillor në lëndët: Konceptet themelore matematikore, Lojërat matematikore, Metodologjia e mësimit të matematikës për fëmijë, Puna me fëmijë të talentuar dhe mësime të njohurive gjeometrike.	0,5
Gjithsej		0.5

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJE NË TITULL	Pikë
VEPRIMTARIA EDUKATIVE - MËSIMORE	109.712
VEPRIMTARIA KËRKIMORE - SHKENCORE	105
VEPRIMTARIA PROFESIONALE - APLIKATIVE	27
VEPRIMTARI ME INTERES MË TË GJERË	0.5
Gjithsej	242.712

Anëtarët e komisionit

1. _____, kryetar

2. _____, anëtar

3. _____, anëtar

Data: 06.12.2023, Tetovë.